



Kërko

Kontakt | Indeksi

Gjykata e Lartë | Lista e Gjykimeve | Vendimet e Gjykatës | Publikime

Njoftime | Programi i Transparencës | Këshilli i Emërimeve në Drejtësi

Kreu > Njoftime

Printo dokumentin

Dërgo Email

Njoftime Për Median

Njoftime Për Publikun

Njoftime me shpallje publike

Vende Vakante

Lidhje Ndhimëse

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
ZYRA E SHTYPIT

Tiranë, 07.07.2020

NJOFTIM PËR MEDIAN

Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë zhvilloi më datë 7.7.2020 procedurën për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të kësaj Gjykate. Në këtë mbledhje ishte i pranishëm edhe Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Referuar kërkesave të nenit 26, pika 3 të Ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH" si dhe të vendimit Nr. 7, datë 21.12.2018 "Rregullore për miratimin e rregullave për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve të gjykatave" të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që parashikojnë zgjedhjen e zëvendëskryetarit nga rradhët e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, pas procesit të verifikimit të përmbushjes së kritereve ligjore për kandidaturën e paraqitur, në prani të 3 gjyqtarëve dhe të 4 ndihmësmagjistratëve të komanduar dhe me të drejtë vote, Mbledhja e Përgjithshme vijoi me kryerjen e procedurës së votimit.

Në përfundim, rezultoi i zgjedhur me unanimitet me 7 vota, Z. Sokol Sadushi, si zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

Pas 13 vjet përvojë profesionale si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese, z. Sadushi ka gëzuar, sipas ligjit përvojën profesionale edhe si gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Për afro 6 vjet ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, funksion i cili, sipas nenit 250, pika 3 e 4 të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", barazohet me atë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe "njihet si periudhë vjetërsie në punë, si gjyqtar, për efekt të kërkesave të karrierës profesionale".

Deri në zgjedhjen e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, z. Sadushi i sapozgjedhur në detyrën e Zëvendëskryetarit do të ushtrojë kompetencat e Kryetarit, referuar nenit 26 pika 2 të Ligjit nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH".



Zyra e Shtypit
Tel/Fax:04227806
<http://www.gjykataelarte.gov.al>

NJOFTIME PËR MEDIAN

07.07.2020

Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë zgjedh Zëvendëskryetarin e kësaj gjykate, Z. Sokol Sadushi

19.06.2020

Njoftim mbi veprimtarinë e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

Lajme të tjera

NJOFTIME PËR PUBLIKUN

07.07.2020

Informacion mbi përfundimin e çështjeve administrative në dhomë këshillimi datë 06 Korrik 2020


Njoftime të tjera



Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë



MASAT E NDËRMARRA NGA KLGJ
PËR PARANDALIMIN E COVID-19



Marrëveshja e mirëkuptimit mes
USAID-KLGJ-Gjykatë e Lartë

NDIHME PER PUBLIKUN



INFORMACION

VENDIMET DHE
BOTIMI I TYREADMINISTRIMI
I ÇËSHTJEVEPROCEDURË TË
PËRSHPEJTUARKOMUNIKO
ME GJYKATËN